

VENDIM
Nr.79, datë 23.10.2009

**PËR MIRATIMIN E MODIFIKIMIT TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË BALKAN GREEN ENERGY SHPK ME SERI PV03K,
NR.3, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.20,
DATË 19.12.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.3, seria PVO3K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Dhe konstatoi se:

- Me vendimin nr.58, datë 7.8.2009 është miratuar fillimi i procedurave për modifikimin e licencës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtur nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k.

- Është paraqitur i plotë dokumentacioni siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si dhe është plotësuar afati 2-mujor për këtë procedurë.

Për gjithë sa më sipër cituar:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e licencës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtur nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k., duke ndryshuar aneksin “A” si në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Impianti	Nr.Njësive	Fuqia e instaluar
----------	------------	-------------------

		lekë
HEC Arras	2	4800
HEC Funares	3	1920
HEC Dukagjin	2	640
HEC Nikolice	2	700
HEC Bulqizë	1	600
HEC Lurë	1	750
HEC Orgjost	2	1200
HEC Lekbibaj	2	1400
HEC Velçan	1	1200
HEC Zerqan	2	625
HEC Borsh	1	250
HEC Leshnicë	2	375
HEC Shoshan	2	3000
HEC Ujanik	1	630
HEC Kerpice	2	350
HEC Barmash	1	630
HEC Voskopojë	1	400
HEC Lunik	1	200
HEC Piqeras	1	200
HEC Homesh	2	395
HEC Muhur	1	250
HEC Rajan	2	620
HEC Marjan	2	420
HEC Lozhan	2	350
HEC Treskë 2	1	250